Nr. 392
Dt. 30.3.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1353/1 Prot

Elbasan më 30 /03/2026

# VENDIM

Nr 33 datë 27 /03/2026.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2026**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë" Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 27 /03/2026

## VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 2026 , 76 familje me fond 233.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Miratoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Konfirmoi: | Zy/Kryetar | A.Shehu |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Elsid Zyma**

**Kryetar I Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar me 36 vota**
**Pro 36**
**Kundër 0**
**Abstenim 1**

1353/2
01.04.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr. 392/1 Prot** **Elbasan, më 1.4.2026**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.33, datë 27.03.2026 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Shkurt 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 393
dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr 1352/1 Prot

Elbasan më 30 /03/ 2026

**VENDIM**

Nr. 34 datë 27 /03/2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi ikushtëzuar për muajin SHKURT 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 27 /03/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Sherbimit Social

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **JANAR 2026** për **242** familje me një fond prej **1.120.354** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Miratoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Konfirmoi: | Zv/Kryetar | A.Shehu |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi Lala**

**Miratuar me** 36 **vota**
**Pro** 36
**Kundër** 0
**Abstenim** 1

1352/2
01.04.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 393/1 **Prot** **Elbasan, më** 1.4.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.34, datë 27.03.2026 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

Ilir Bejtja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 394
Dt. 30.3.2026

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# BASHKIA ELBASAN
# KËSHILLI BASHKIAK

**Nr. 3191/1 Prot.** **Elbasan, më 30.03.2026**

**VENDIM**

**Nr. 35 datë 27.02.2026**

***"Për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a."***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___.02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Buxhet - Financës në bashki, për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a., mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr. 9228 datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i ndryshuar), në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në ligjin nr. 10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), në VKM nr. 248 datë 10.4.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël të organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore" (i ndryshuar), si dhe në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Të miratojë transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime" sh.a., sipas tabelës së mëposhtme:

| *Nr.* | *Llogaria ekonomike* | *Emërtimi* | *Vlera* | *Institucioni ku transferohen* |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2136100 | "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 68,807,741 | Shoqëria Rajonale "UKE" sh.a. |
| 2 | 2136100 | Mbikqyrje "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 1,169,550 | |
| 3 | 2136100 | Kolaudim "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 100,000 | |
| | | ***Shuma*** | **70,077,291** | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet - Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Elsid Zyma**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

*Konceptoi:*

*Drejtori i Buxhet - Financës:* *A. Merkja*

*Drejtori Juridik dhe Informacionit:* *A. Hoxha*

*Pranoi:*

*Drejtori i Përgjithshëm i SHM:* *S. Mehmeti*

*Miratoi:*

*Zv/kryetare:* *K. Krasnika*

714/2
10.04.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 394/1 **Prot** **Elbasan, më** 10.4**.2026**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.35, datë 27.03.2026 "Për tranferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**
**Ilir Bejtja**

Nr. 395
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 1039/1 **Prot.** **Datë** 30 **.03. 2026**

**VENDIM**

**NR.** 36 **DATE** 27 **. 03. 2026**

**MBI**

**"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028", si dhe përdorim i grantit për performance".**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .03.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2026, dhe periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe përdorim i grantit për performance", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20 dhe nr.1, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr.18133/1, datë 24.12.2025,

**VENDOSI**

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028, grant dhe të ardhura, njësia shpenzuese Bashkia dhe insitucionet vartëse, për financimin e objekteve për investime, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Detajimin e fondit 6,292,134.83 lekë, Grant i Bazuar në Performancë, me burim financimi nga buxheti i shtetit, trashëguar nga viti 2025, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe ASHPU.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja

Dr.Juridike: A.Hoxha

**SEKRETAR**
**Elsid Zyma**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

Tab. Nr.1

**“Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028”,**

***PAKSIME :***

ne leke

| Gr | Progr. | Funks. | Produk. | Kap | Art | Kodi instit. | Institucioni | Shuma/2026 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | "Ndertimi i rruges se re nga Rotonda e varrezave deri ne intersektimin me rrugen "Nos Josifi", Lagja "Emin Matraxhiu", (bashkefin. me FSHZH) ( vlera e projektit =63,274,150) | *Bashkia* | 6,327,415 | | | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | "Rivitalizimi Urban i shesheve ne anen veriore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori", (bashkefin. me FSHZH), (vlera e projektit = 77,522,162 leke ) | *Bashkia* | 7,752,216 | | | |
| 00 | AB109 | 10910 | V091AAB | 5 | 231 | “Ndërtim i këmbëve dhe speronave të urës tip beli mbi përroin Lugaj, në fshatin Labinot Katund, Nj.Admin, Labinot Mal” (tep. prok.) | *Bashkia* | 1,000,000 | | | |
| 00 | AG109 | 09230 | V923AAB | 5 | 231 | "Mobilim i ambienteve ndihmese te aktiviteteve sportive per grupmoshat e nxenesve te qytetit, Lagj. "Q.Stafa" (tep. prok.) | *D.P.Arsimit* | 1,000,000 | | | |
| 00 | AG109 | 09230 | V923AAB | 5 | 231 | "Blerje Grand PianoYamaha GC1" (teprice fondi) | *D.P.Arsimit* | 1,554,000 | | | |
| 00 | AH109 | 10430 | V043AAF | 5 | 231 | "Mobilim i çerdhes Nr.5, në lagjen “Kongresi i Elbasanit”, (tep.prok.) | *D.P.Arsimit* | 8,139,543 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAJ | 5 | 604 | Diference detyrimi kuote anetaresie K.Qarkut | *Bashkia* | 1,300,000 | | | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | Fv barriera mbrojtese (teprice fondi) | *ASHPU* | 1,000,000 | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | **Totali :** | | **28,073,174** | **0** | **0** | |

***SHTESA:***

ne leke

| Gr | Progr. | Funks. | Produk. | Kap | Art | Kodi instit. | Institucioni | Shuma/2026 | 2027 | 2028 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | "Ndertimi i rruges se re nga Rotonda e varrezave deri ne intersektimin me rrugen "Nos Josifi", Lagja "Emin Matraxhiu" (finacim 2026-2028, vlera e projektit =64,900,688) | *ASHPU* | 12,900,688 | 26,000,000 | 26,000,000 | 64,900,688 |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Supervizim " " | *ASHPU* | 564,894 | | | 564,894 |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Kolaudim " " | *ASHPU* | | 84,734 | | 84,734 |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5+1 | 231 | "Rivitalizimi Urban i shesheve ne anen veriore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori" (finacim 2026-2028, vlera e projektit = 76,583,497 leke ) (financ.te ardh.+ gr.perform.) | *ASHPU* | 9,291,362 | 31,000,000 | 30,000,000 | 70,291,362 |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Supervizim " " | *ASHPU* | 816,230 | | | 816,230 |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Kolaudim " " | *ASHPU* | | 122,435 | | 122,435 |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 5 | 231 | "Sistemi i kamerave per koshat e mbetjeve te ngurta" (shtese fondi) | *Bashkia* | 4,500,000 | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | **Totali :** | | **28,073,174** | **57,207,169** | **56,000,000** | **136,780,343** |

BASHKIA ELBASAN - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tab. Nr.2

**"Perdorim i grantit per performance, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit " (fond i trasheguar nga viti 2025)**

ne leke

***SHTESA:***

| Gr | Progr. | Funks. | Produk. | Kap | Art | Kodi instit. | Institucioni | Shuma/2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 1 | 231 | Rivitalizimi Urban i shesheve ne anen veriore te unazes Jugore ndelidhese midis kryqezimit te Cerrikut dhe rruges "25 Nentori" (bashkefin. me FSHZH), (vlera total projektit = 76,583,497 leke ) (financ.te ardh.+ gr.perform.) | *ASHPU* | 6,292,134.83 |
| | | | | | | **Totali :** | | **6,292,134.83** |
| | | | | | | | | |

1039/2
10.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 395/1 Prot

Elbasan, më 10.4.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.36, datë 27.03.2026 "Për transferim fondi në buxhetin e vitit 2026 për periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe përdorimin e grantit për performancë", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa",prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

Nr. 396
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 1020/1 **Prot.** **Elbasan më,** 30.03.**2026**

**VENDIM**

**Nr.** 37 **Datë:** 27.03.**2026**

Për miratimin e kontratës së **" Shërbimit Publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan"** në Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane, për vitin 2026 të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë " ECO – ELB " sh.a.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 27/03/ 2026, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave e Bashkisë Elbasan, bazuar në :

- Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij ;
- Ligji Nr.57 datë 07.11.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Ligjit Nr . 162/2020, datë 23.12.2020 " Për prokurimin publik ", nenet 9 dhe 11;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **" Shërbimit Publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan "** në Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqerisë " ECO – ELB " sh.a. për vitin 2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Monitorimit dhe Financës e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore ".

| | |
|---|---|
| Përgj.DM | A.Hajrulla |
| Dr. Monitorimit | K. Gripshi |
| Dr.P. M.C.M.B.P.K | Sh. Cullhaj |
| Dr. Financë | A. Merkja |
| Dr. Juridik | A. Hoxha |

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Elsid Zyma** **Lutfi Lala**

1020/2
01.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr.396/1 prot. Elbasan, më 1.4.2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.37 datë 27.03.2026 "Për miratimin e kontratës së shërbimit publik për pranimin, depozititmin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan, në impiatin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan për vitin 2026, midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë ECO-ELB Sh.A.", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Kopje IKB

| REPUBLIKA E SHQIPËRISË<br>SHOQËRIA "ECO-ELB" SHA | REPUBLIKA E SHQIPËRISË<br>BASHKIA ELBASAN |
|---|---|
| Nr. 161 Prot. | Nr. 1877 Prot. |
| Datë 08.04.2026 | Datë 08.04.2026 |

**KONTRATË SHËRBIMI PUBLIK**

**PËR**

**PRANIMIN, DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN E MBETJEVE TË BASHKISË ELBASAN NË IMPIANTIN E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT TË ELBASANIT**

Lidhur sot më datë 08/04/2026, midis palëve:

-**Bashkia Elbasan**, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, që funksion sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Elbasan, me adresë: Rruga " Qemal Stafa", përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **z. Gledian Llatja,** referuar për efekt të kësaj kontrate si **"Autoriteti Kontraktor"**,

dhe

-Shoqëria "ECO-ELB" sh.a., e regjistruar në QKB në datë 6.12.2021, me numër identifikimi NUIS M13606204T, me seli në Elbasan, përfaqësuar nga administratorj **Z. Leli Kaja,** i datëlindjes 15.04.1976, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan me shtetësi ***Shqiptare***, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi, letërnjoftimi nr. H60415101Ë, referuar në këtë kontratë si **"Shoqëria Kontraktuese"**.

**Neni 1**
**Baza ligjore**

Kjo kontratë referohet dhe lidhet bazuar në:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Ligji Nr.160/2020 "Për prokurimin publik" (neni 11, pika 1);
- Ligji Nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr.57 datë 07.11.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025 dhe Shtojcat për zbatimin e tij;
- Plani Vendor i "Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve" Bashkia Elbasan 2025-2030 me VKB Nr.65, datë 30.05.2025
- Rregullore "Për Administrimin e Mbetjeve" Bashkia Elbasan 2025-2030 me VKB Nr.66, datë 30.05.2025
- VKM Nr.99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve";
- VKM Nr.452, datë 11.07.2012 "Për lendfillet e mbetjeve";

- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a Nr 03 datë 02.03.2022 "Për miratimin e planit ekonomik 2022 dhe tarifave për trajtimin e mbetjeve pranë shoqërisë "ECO- ELB" sh.a.
- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a. Nr.17 datë 26.12.2023 "Për miratimin e Planit Ekonomik për vitin 2024" pranë Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a.
- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a. Nr.01 datë 17.02.2026 "Për lënien në fuqi të tarifës së mbetjeve për vitin 2026 të Shoqërisë "ECO-ELB"
- Kontrata e qirasë Nr.156, datë 23.03.2023 midis Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe "ECO-ELB" sh.a.
- **Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.______datë ___________**

**Neni 2**
**Qëllimi i kontratës**

Kjo kontratë ka si qëllim rregullimin e marrdhënieve midis palëve, në proçesin e pranimit të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan, në impjantin e përpunimit me djegie të mbetjeve (inceneratorin e Elbasanit) në administrim të shoqërisë "ECO-ELB" sh.a.

**Neni 3**
**Përkufizime**

**3.1.** "Mbetje urbane", në kuptim të kësaj kontrate përfshihen të gjitha **mbetjet** (sipas përkufizimit që bën Ligji nr.57 datë 07.11.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar) që grumbullohen dhe vijnë nga Bashkia ose nga operatori ekononomik (ose bashkimi i operatorëve) i përzgjedhur dhe i kontraktuar nga Bashkia, për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan.

**3.2.** "Menaxhim i integruar i mbetjeve" është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve.

**3.3.** "Impiant incinerimi" është impianti i administruar nga Shoqëria kontraktuese, sipas marrëveshjes së lidhur midis kësaj të fundit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Impianti i incinerimit është ndërtuar nga shoqëria "ALBTEK ENERGY" sh.p.k., sipas Kontratës së Koncesionit të formës "BOT", me Nr.11026/7, datë 16.12.2014, të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit, dhe shoqërisë "ALBTEK ENERGY" sh.p.k. dhe që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve. Ky përkufizim mbulon vendndodhjen dhe të gjithë impiantin e incinerimit, përfshirë të gjitha linjat e incenerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incenerimit.

**3.4.** Përkufizimi i termave të tjerë të kësaj kontrate do të bëhet sipas përkufizimeve që bëhet në kuadrin ligjor dhe nënligjor aktual në fuqi.

**Neni 4**
**Objekti i kontratës**

**4.1.** Objekt i kontratës është pranimi, depozitimi (grumbullimi) dhe trajtimi i mbetjeve urbane të Autoritetit Kontraktor në lendfillin e mbetjeve, i ndërtuar dhe i liçensuar për këtë qëllim, në administrim të shoqërisë "ECO-ELB" sh.a., kundrejt pagimit të çmimit të kontratës.

**4.2. Shoqëria Kontraktuese** do të ofrojë shërbimin për pranimin, grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan, ku do të përfshihen shërbimet si më poshtë;

i. **Pranimi** i mbetjeve që do të depozitohen nga vetë Bashkia apo nga operatori ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan i përbërë nga territori administrativ i Bashkisë (qytetit) Elbasan, si dhe pranimi i mbetjeve të njësive administrative (rajonet) e bashkisë. Elbasan: Bradashesh, Papër, Funar, Gracen, Labinot Fushë, Labinot Mal, Shirgjan, Shushicë, Gjinar, Zavalinë, Tregan, Gjinar.

ii. **Grumbullimi** (depozitimi) i mbetjeve sipas pikës (i) në vend depozitimin e mbetjeve të "Impiantit të incinerimit".

iii. **Trajtimi** që përfshin përpunimin (seleksionimin) e mbetjeve që do të depozitohen sipas pikave të mësipërme.

**4.3.** Shoqëria Kontraktuese do të ofrojë shërbime rajonale të menaxhimit të mbetjeve, si më sipër, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe Lejen Mjedisore.

**4.4.** Për shërbimet e kryera, Shoqëria Kontraktuese do të përfitojë pagesën sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

## Neni 5
## Afati i Kontratës

**5.1. Afati i kësaj kontrate fillon me lidhjen e saj dhe përfundon në datë 31/12/2026, dhe i shtrin efektet që nga data 01.01.2026**

**5.2.** Pavarësisht afatit të parashikuar në pikën (1), efektet e kësaj kontrate **do të ndërpriten** para afatit të mësipërm, në momentin që do të kete ndryshime në statusin apo në raportet që shoqëria "ALBTEK ENERGY" sh.p.k. ka me institucionet e shtetit Shqiptar, ndryshime këto që sjellin efekt në administrimin e Impiantit të Incenerimit dhe në zbatimin e kësaj kontrate.

**5.3.** Efektet e kësaj kontrate **nuk do të ndërpriten** para afatit të mësipërm, nëse gjatë kësaj periudhe (deri më 31.12.2026) "Impianti i incenerimit" i transferohet në pronësi shoqërisë Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a, në zbatim të Kontratës Koncesionare të formës "BOT", me Nr.11026/7, datë 16.12.2014, e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit, dhe shoqërisë "ALBTEK ENERGY" shpk, me objekt "Ndërtimin, Operimin (administrimin) dhe Transferimin e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan".

**5.4.** Pavarësisht parashikimit të dispozitave të mësipërme, kjo kontratë do të shtrijë efektet edhe për ngarkesat e mbetjeve, të depozituara nga Bashkia Elbasan, prej datës 1 Janar 2025 deri në datën e lidhjes se kësaj kontrate. Edhe për këto ngarkesa mbetjesh, shoqëria "ECO – ELB" sh.a. do të lëshojë faturë tatimore, duke respektuar parashikimet e kësaj kontrate

## Neni 6

## Transporti i mbetjeve dhe metodologjia e shërbimit

**6.1.** Transportimi i mbetjeve për në vendgrumbullimin e shoqërisë kontraktuese do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet operatorit ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë, si dhe nëpërmjet transportuesve të tjerë të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (psh. për njësitë administrative rurale). Shoqëria kontraktuese i merr në dorëzim ngarkesat e mbetjeve tek hyrja e vendgrumbullimit të Impiantit të incinerimit.

**6.2.** Shoqëria kontraktuese nuk do të pranojë mbetje të cilat ndalohen nga leja mjedisore dhe mbetje të tjera të klasifikuara si të rrezikshme sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve (si psh. mbetjet spitalore, bateritë e vjetra dhe akumulatorët, pajisjet elektrike dhe elektronike, vajrat e përdorur, etj.).

**6.3.** Dërgesat e mbetjeve do të kontrollohen, do të peshohen dhe do të regjistrohen në vend-depozitim menjëherë. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet operatorit ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë, si dhe transportuesit e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor, pajisen me fletë-peshimin e gjeneruar nga peshorja për çdo sasi të depozituar.

**6.4.** Vend depozitimi do të jetë i hapur gjatë gjithë ditëve të javës, për 24 orë pa ndërprerje, për të pritur mbetjet.

**Neni 7**
**Çmimi i Kontratës**

**7.1.** Pagesa e çmimit të kontratës do të realizohet me pagesa javore, që do të kryhen në favor të Shoqërisë Kontraktuese nga Bashkia (Autoriteti Kontraktor).

**7.2.** Pagesa javore për mbetjet e dorëzuara nga Autoriteti Kontraktor bazohet në **sasinë e mbetjeve të depozituar gjatë javës** dhe në **çmimin për njësi/ton mbetje**.

**7.3.** Çmimi për njësi/ton mbetje përfshin garancinë për mbylljen e të gjithë shërbimeve (pranimi, grumbullimi, trajtimi), në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe gjithë kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

**7.4.** Çmimi për ton mbetje të përpunuara, do të jetë sipas Vendimit Nr 01 , datë 17.02.2026 i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

**7.5.** Çmimi për ton mbetje nuk mund të ndryshohet gjatë afatit të zbatimit të kontratës, përveçse kur kanë ndryshuar kostot e shërbimit, pas miratimit të shprehur nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë kontraktuese.

**7.6.** Brënda 6 (gjashtë) muajve nga fillimi i zbatimit të kësaj kontrate, shoqëria kontraktuese ka detyrimin të hartojë një analizë të detajuar të kostove faktike, që përfshihen në çmim.Nëse nga kjo analizë cmimi për njësi do të rezultoj i ndryshëm nga ai i përcaktuar në këtë kontratë, palët do të bëjnë rakordimet për detyrimet e ndërsjellta.

**7.7.** Modaliteti i ndryshimit të çmimit për njësi/ton mbetje do të bëhet transparent. Bashkia ka të drejtë të kërkojë një analizë të detajuar të kostove që përfshihen në çmim si dhe të kundërshtojë dhe paraqesë rezervat e saj kur gjykon që çmimi i përcaktuar nuk përfaqëson drejt dhe saktë kostot reale të shërbimit.

**7.8.**Çmimi nga data **01.01.2026** çmimi i përcaktuar si më sipër është **2,600** (dymijë e gjashtëqind) lekë/ton mbetje pa tvsh,

**Neni 8**
**Mënyra e bërjes së pagesës**

**8.1.** Shoqëria kontraktuese i paraqet Autoritetit Kontraktor një **Raport/Situacion** mbi sasitë e mbetjeve të pranuara, grumbulluara dhe përpunuara gjatë javës paraardhëse, si dhe një **Faturë** për shërbimet, bazuar në nenin 7.

**8.2.** Bashkia, nëpërmjet strukturave të saj, bën verifikimet dhe rakordimet me informacionin periodik të marrë nga shoqëria mbi sasinë e mbetjeve të depozituara, vërtetimet e

transportuesve të lëshuara nga shoqëria kontraktuese për çdo ngarkesë. Në rast mospërputhjesh apo pasaktësish, Bashkia e kthen faturën dhe raportin/situacionin për korrigjim. Raporti/Situacioni i paraqitur paguhet, pasi është nënshkruar nga mbikqyrësi/punonjësi/struktura e caktuar për monitorimin e kësaj kontrate nga Bashkia.

**8.3.** Pagesa e faturës bëhet brenda 10 ditëve nga paraqitja e saj, apo nga riparaqitja në rast korigjimi.

**8.4.** Të gjitha pagesat sipas kontratës do të kryhen me transfertë bankare në llogarinë bankare të Shoqërisë Kontraktuese.

Llogaria e Bankës: BKT

IBAN i Bankës: AL51205317750076 26CLPBCLALLE

## Neni 9
## Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Kontraktuese

**9.1.** Shoqëria Kontraktuese do të pranojë në ambjentet e saj, mbetjet urbane nga Bashkia të sjella nga ajo apo të tretë të kontraktuar prej saj. Pavarësisht sa më sipër, shoqëria nuk do të pranojë mbetje të rrezikshme të përcaktuara si të tilla nga Katalogu Shqiptar i Mbetjeve apo akte ligjore e nënligjore.

**9.2.** Shoqëria Kontraktuese do të garantojë të gjitha kushtet e nevojshme teknike për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e tyre dhe përpunimin në impjant, sipas standarteve dhe kërkesave të përcaktuara në lejen mjedisore dhe liçencat e shoqërisë kontraktuese.

**9.3.** Shoqëria Kontraktuese do të peshojë të gjitha mbetjet e dërguara në ambjentet e saj, dhe do të pajisë transportuesin, qoftë i Bashkisë apo i të tretëve të kontraktuar prej saj, me vërtetimin e dërgesës së mbetjeve dhe peshën e tyre.

**9.4.** Shoqëria Kontraktuese do të përdorë regjistrimin në kohë reale për të regjistruar mbetjet që pranohen në vend depozitim dhe sisteme të besueshëm të informacionit të menaxhimit që lejojnë verifikimin e sasive të mbetjeve nga ana e Bashkisë.

**9.5.** Shoqëria Kontraktuese do të informojë Bashkinë periodikisht, **çdo javë,** për sasinë e mbetjeve të depozituara prej saj apo të tretëve të kontraktuar prej saj.

**9.6.** Punimet në vend-depozitim, trajtimi i mbetjeve, operacionet pas përpunimit dhe monitorimi do të kryhen në përputhje me legjislacionin, me lejen mjedisore dhe liçensat e shoqërisë kontraktuese.

**9.7.** Shoqëria Kontraktuese do të informojë Bashkinë dhe do të paraqesë të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, sa herë t'i kërkohet nga kjo e fundit, në lidhje me koston e shërbimit dhe çmimin e aplikuar.

**9.8.** Shoqëria Kontraktuese do të përfitojë prej Bashkisë pagesën e çmimit të kontratës.

## Neni 10
## Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

**10.1.** Bashkia do të dorëzojë mbetjet urbane në ambjentet e shoqërisë, të caktuara nga kjo e fundit, nëpërmjet strukturave të saj apo të tretëve të kontraktuar prej saj.

**10.2.** Bashkia do të pajisë me autorizim të posaçëm të gjitha mjetet e transportit, të vetat apo të tretëve të kontraktuar prej saj, që do të kryejnë transportin e mbetjeve në ambjentet e shoqërisë.

**10.3.** Bashkia ka të drejtë të ushtrojë kontroll apo të inspektojë proçesin e përpunimit të mbejtjeve nga shoqëria, periodikisht apo në çdo kohë sipas gjykimit të saj.

**10.4.** Bashkia do të bëjë pagesën e çmimit të kontratës sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

**Neni 11**

**Përgjegjësia për shkeljet**

**11.1.** Të gjitha sanksionet e vendosura nga autoritetet kompetente për shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me veprimtaritë e Shoqërisë Kontraktuese janë përgjegjësi e kësaj të fundit.

**11.2.** Në rast se Shoqëria Kontraktuese nuk do të kryejë shërbimin në kohë dhe cilësi, sipas kësaj kontrate dhe kuadrit ligjor në fuqi, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me pretendimet për dëmin e shkaktuar, sipas ligjit në fuqi.

**11.3.** Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk do të procedojë me kryerjen e pagesës në kohë, sipas kontratës, ky i fundit do të mbajë përgjegjësi për shkeljen e Kontratës. Shoqëria Kontraktuese në këtë rast do të procedojë me pretendimet për dëmin e shkaktuar, sipas ligjit në fuqi.

**Neni 12**

**Mbikqyrja e Kontratës**

**12.1.** Për zbatimin e rregullt të Kontratës, palët autorizojnë Mbikqyrësin e Kontratës, përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Kontratës.

**12.2.** Mbikqyrësi i Kontratës i emëruar do të jetë përgjegjës për komunikimin midis Palëve, në lidhje me të gjitha çështjet kontraktuale. Në rast zëvendësimi të Mbikqyrësit aktual, njëra palë do të njoftojë menjëherë palën tjetër rreth këtij zëvendësimi.

**12.3.** Mbikqyrësi i Kontratës, i emëruar nga Shoqëria Kontraktuese është:
**Z. Leli Kaja** Email: ecoelb@gmail.com Nr. telefoni: +355 693933345
**12.4.** Mbikqyrësi i Kontratës i emëruar nga Autoriteti Kontraktues është:
**Z. Denis Pëllumbi** , Përgjegjës i Sektorit të Pastrimit pranë Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale,
Email: pellumbidenis40@gmail.com Nr. telefoni: 0683380800
**Z. Ardian Pisha** Specialist i Sektorit të Analizave dhe Statistikave
Email: ardianpisha@yahoo.com
Nr.tel: 0682165967

**Neni 13**

**Mekanizma kundër parregullsive**

**13.1.** Asnjëra nga palët nuk do të lejojë parregullsi në kryerjen e punës së vet sipas kontratës, dhe menjëherë do të njoftojë palën tjetër në rast se dyshohen parregullsi që lidhen me kontratën.

**13.2.** Asnjëra palë nuk do të nxjerrë informacion, të përcaktuar si konfidencial (me përdorim të kufizuar).

**Neni 14**

**Ndërprerja e shërbimit për shkak të forcave madhore**

Në rastet e dukurive të paparashikuara të zjarreve, tërmeteve, reshjeve të dendura të borës, përmbytjeve, rrëshqitjeve të dheut, aksidenteve industriale dhe ndotjes mjedisore, Shoqëria Kontraktuese zbaton detyrimet e tij duke përmbushur objektin e kontratës, sipas Planit të emergjencave, udhëzimeve përkatëse dhe kushteve të lejes operative.

**Neni 15**

**Përfundimi i Kontratës**

**14.1.** Vlefshmëria e kësaj kontrate përfundon:

i. me skadimin e afatit të Kontratës, sipas dispozitave të Kontratës;

ii. në rast të ndryshimeve në ligje që e bëjnë të pamundur zbatimin e kësaj kontrate;

iii. në rast të transferimit të impiantit në një vendodhje tjetër, për depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane.

**14.2.** Në rastin e përfundimit të kontratës Autoriteti Kontraktor do t'i paguajë Shoqërisë Kontraktuese pagesën për punën e kryer përpara përfundimit të Kontratës.

**Neni 16**

**Kushte të tjera**

**15.1.** Të gjitha komunikimet midis palëve, të cilat lidhen me këtë kontratë, për të qenë të vlefshme duhet të bëhen me shkrim.

**15.2.** Çdo amendim i kësaj kontrate është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

**Neni 17**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**16.1.** Palët e kësaj Kontrate do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës ose që lidhen me kontratën, me interpretimin e saj, pavlefshmërinë, shkeljet ose përfundimin e saj, me negociim dhe marrëveshje të ndërsjelltë me shkrim. Në rast se mosmarrëveshja nuk arrin të zgjidhet me negocim e marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

**16.2.** Për çështjet që nuk rregullohen sipas kësaj Kontrate, janë të vlefshme dispozitat e Kodit Civil Shqiptar.

Kontrata hartohet në tre kopje të njëjta, një për secilën palë.

| Shoqëria Kontraktuese | Autoriteti Kontraktor |
|---|---|
| **"ECO-ELB" sh.a** | **BASHKIA ELBASAN** |
| Administratori | Kryetari i Bashkisë |
| **Leli KAJA** | **Gledian Llatja** |
| | **Me Urdhër dhe me porosi** |
| | **Zv/ Kryetar** |
| | **Asim Sula** |

Nr. 396
Dt. 30.3.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

**Nr. 1024 Prot.** **Elbasan më, 30.03.2026**

**VENDIM**

**Nr. 37 Datë: 27.03.2026**

Për miratimin e kontratës së **" Shërbimit Publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan"** në Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane, për vitin 2026 të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë " ECO – ELB " sh.a.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 27./03./ 2026, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave e Bashkisë Elbasan, bazuar në :

- Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij ;
- Ligji Nr.57 datë 07.11.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Ligjit Nr . 162/2020, datë 23.12.2020 " Për prokurimin publik ", nenet 9 dhe 11;

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **" Shërbimit Publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan "** në Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqerisë " ECO – ELB " sh.a. për vitin 2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Monitorimit dhe Financës e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore ".

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Elsid Zyma** **Lutfi Lala**

387
23.03.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 552/1 Prot.** **Elbasan, më 30.03.2026.**

# V E N D I M

**Nr. 38 Datë: 27.03. .2026**

***"Mbi miratimin e "Metodologjia e Shpërndarjes dhe Përdorimit të Fondit të Planifikuar në Buxhetin e Vitit 2026" për Akademinë e Futbollit Elbasani"".***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar;; ligjin nr. 79/2017 "*Për Sportin*", i ndryshuar; ligjin ne. 9936/2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*,i ndryshuar, programin buxhetor 08130 *"Sporti dhe Aktivitetet Rinore"* , Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar *"Mbi miratimin e "Metodologjia e Shpërndarjes dhe Përdorimit të Fondit të Planifikuar në Buxhetin e Vitit 2026" për Akademinë e Futbollit Elbasani"":*

## V E N D O S I :

1. Miratimin e *"Metodologjia e Shpërndarjes dhe Përdorimit të Fondit të Planifikuar në Buxhetin e Vitit 2026" për Akademinë e Futbollit Elbasani.*
2. Akademia e Futbollit Elbasani nuk ka të drejtë të ndryshojë destinacionin e përdorimit të këtyre fondeve .
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të Bashkisë Elbasan
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**
**Elsid Zyma**

| | |
|---|---|
| *Konceptoi:* | *F.Dishani* |
| *Konc& miratoi* | *S.Ndria* |
| *Drejtoria P.P.S* | *G.Dyrmyshi* |
| *Drejtoria B.F* | *A.Merkja* |
| *Drejtoria P.K.S.A.R* | *D.Rroseni* |
| *Zv/Kryetar:* | *K. Krasnika* |

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 31

Vota kundër 0

Vota Abstenim 2.

Zbardhur më datë 30/03/2026

1552/1
01.04.2026.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 397/1 **Prot.** **Elbasan më** 1 . 4 . **2026**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.38, datë 27.03.2026, "Mbi miratimin e 'Metodologjia e shpërndarjes dhe përdorimit të fondit të planifikuar në buxhetin e vitit 2026' për Akademinë e Futbollit Elbasani" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

Nr. 398
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**

**Nr.1330/1 prot.** **Elbasan, më: 30 .03.2026**

**VENDIM**
**Nr. 33 Datë: 27 .03.2026.**

***"Për një ndryshim në VKB Nr.141 datë 27.11.2025 "Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2026, në qytetin e Elbasanit".***

Bazuar në shkresën Nr. 628/2 datë 23.01.2026 Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026, nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për sa i përket tabelës nr.6, Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë është deri në 60%. Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, ligji nr.22/2018 *"Për Strehim Social"*, i ndryshuar, V.K.M. nr. 459 datë 03.07.2019 *"Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim"*; V.K.M. nr. 384 datë 12.06.2019 *"Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"*, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit:

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e *"Listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2026, në qytetin e Elbasanit"*, sipas listës bashkëlidhur.
1. Miratimin në parim, të masës së subvencionimit të qirasë me vlerë totale prej ***37.643.356.20 lekë*** për periudhën *(Janar-Dhjetor)* viti 2026, për t'u financuar në masën ***60%*** nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në vlerën ***22,586,013.72 lekë*** dhe në masën ***40%*** nga Bashkia Elbasan në vlerën ***15,057,342.48 lekë.***
2. Paraqitjen e listës emërore të familjeve përfituese, bashkëlidhur këtij vendimi, për miratim në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.
3. Dhënia e subvencionimit do të bëhet për cdo rast pas verifikimit të plotësimit të kritereve ligjorë dhe diferenca shtesë e krijuar nga vlera 30% në 40%. të subvencionimnit do të financohet nga të ardhurat e bashkisë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari**
**Elsid Zyma**

**Kryetari**
**Lutfi Lala**

*Konceptoi: A. Beqiri*
*Drejtoria P.P.S:*
*Drejtoria P.Sh.M:*
*Drejtoria F.B.:*
*Drejtoria J. I:*
*Zv/Kryetar:*

*R. Gremi*
*G. Dyrmyshi*
*S. Mehmeti*
*A. Merkja*
*A. Hoxha*
*K. Krasnika*

*T. Sinanaj*

Miratuar me 34 vota

Vota Pro 34

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 30/03/2026

1330/2
01.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr.398/1 Prot.

Elbasan më 1 . 4 . 2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.39 datë 27.03.2026 "Për një ndryshim në VKB nr.141 datë 27.11.2025 "Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje për vitin 2026 në qytetin e Elbasanit" konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

Nr. 399
Dt. 30.3.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Nr.** 1522/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 30**.03.2026.**

# V E N D I M

**Nr.** 40 **Datë:** 27.03**.2026.**

***"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan".***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 *"Për Kadastrën"*; ligjin nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 *"Për përcaktimin e proçedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve"*, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike :

## V E N D O S I :

1. Miratimin për fillimin e proçedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr. 4 dhe nr. 8, ndodhur në Z.K. 3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**
**Elsid Zyma**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

| | |
|---|---|
| *Konceptoi: A. Braneshi* | |
| *Drejtoria P.P.S:* | *G. Kerri* |
| *Drejtoria F.B.:* | *G. Dyrmyshi* |
| *Drejtoria P.U:* | *A. Merkja* |
| *Drejtoria D.P.P.D.U:* | *M. Avllazagaj* |
| *Drejtoria P.Sh.M:* | *K. Haxhihyseni* |
| *Drejtoria J. I:* | *S. Mehmeti* |
| | *A. Hoxha* |
| *Zv/Kryetar:* | *K. Krasnika* |

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 30 / 03 /2026

1522/2
31.03.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 399/1 Prot.

Elbasan më 31.3.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.40, datë 27.03.2026, "Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të pasurive nr.3, nr.4, dhe nr.8 ndodhur në Z.K.3589, Njësia Administrative Gjergjan dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN -

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al, email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

Nr. 400
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 1305/1 Prot.** **Datë 30. 03. 2026**

## VENDIM

**NR. 41, DATË 27. 03. 2026**

**MBI**

## "VLERSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PER VITET 2027-2029

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë ____. 03. 2026, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga administrata e Bashkia Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, "Mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2027-2029", mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029",

**VENDOSI :**

1. Miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Elbasan për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme 2027-2029, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.

3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETAR**
**Elsid Zyma**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

| | |
|---|---|
| Sekt.Buxhetit: | M.Behluli |
| Dr.Buxhet Fin.: | A.Merkja |
| D.P.Sh.M: | S. Mehmeti |
| D.P.K.S.A.R.S : | D.Rroseni |
| D.P.M.C.M.B.P.K : | Sh. Çullhai |
| Dr.Juridike: | A.Hoxha |
| Zv/kryetar : | K. Krasnika |

BASHKIA ELBASAN

VLERESIMET DHE PRASHIKIMET AFATMESME TE TE ARDHURAVE TE BASHKISE ELBASAN PER PERIUDHEN 2024-2029

ne mije leke

| | EMERTIMI | FAKT 2024 | FAKT 2025 | PLANIFIKIMI 2026 | PARASHIKIMI 2027 | PARASHIKIMI 2028 | PARASHIKIMI 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | **Te ardhura nga taksat** | **430,665** | **353,074** | **569,700** | **581,094** | **592,717** | **604,571** |
| 1 | Tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e BV | 1,467 | 534 | 1,500 | 1,530 | 1,561 | 1,592 |
| 2 | Taksa mbi token bujqesore | 21,878 | 20,141 | 27,100 | 27,642 | 28,195 | 28,759 |
| 3 | Taksa mbi ndertesat | 230,516 | 193,402 | 289,000 | 294,780 | 300,676 | 306,689 |
| 4 | Taksa mbi truallin | 60,590 | 28,046 | 35,000 | 35,700 | 36,414 | 37,142 |
| 5 | Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier | 8,220 | 8,156 | 10,000 | 10,200 | 10,404 | 10,612 |
| 6 | Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja | 101,236 | 95,723 | 200,000 | 204,000 | 208,080 | 212,242 |
| 7 | Taksa e tabeles | 6,758 | 7,072 | 7,100 | 7,242 | 7,387 | 7,535 |
| | | | | | | | |
| B | **Te ardhura nga taksat e ndara** | **164,096** | **178,338** | **182,600** | **186,252** | **189,977** | **193,777** |
| 1 | Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite e palujtshm | 13,702 | 6,487 | 7,000 | 7,140 | 7,283 | 7,428 |
| 2 | Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura | 86,415 | 92,987 | 94,800 | 96,696 | 98,630 | 100,603 |
| 3 | Renta minerare | 577 | 547 | 800 | 816 | 832 | 849 |
| 4 | Tatimi mbi te ardhurat personale | 63,402 | 78,317 | 80,000 | 81,600 | 83,232 | 84,897 |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura nga tarifat** | **412,476** | **429,021** | **722,246** | **736,691** | **751,426** | **766,453** |
| 1 | Tarife zenie hapes.publike (tavolina + zenie hapesire) | 29,698 | 26,430 | 32,000 | 32,640 | 33,293 | 33,959 |
| 2 | Tarife pastrimi | 183,502 | 185,980 | 280,000 | 285,600 | 291,312 | 297,138 |
| 3 | Tarife gjelberimi | 41,899 | 43,653 | 70,000 | 71,400 | 72,828 | 74,285 |
| 4 | Tarife ndricimi | 62,626 | 68,377 | 120,000 | 122,400 | 124,848 | 127,345 |
| 5 | Tarife miremb.infrastukture ne Nj.Administrative | 5,164 | 4,548 | 11,400 | 11,628 | 11,861 | 12,098 |
| 6 | Tarife reklame | 4,272 | 4,374 | 4,800 | 4,896 | 4,994 | 5,094 |
| 7 | Tarife parkimi | 12,568 | 14,984 | 98,728 | 100,703 | 102,717 | 104,771 |
| 8 | Tarife embleme | 67 | 74 | 68 | 69 | 71 | 72 |
| 9 | Tarife leje certifikate transporti | 2,026 | 2,291 | 1,500 | 1,530 | 1,561 | 1,592 |
| 10 | Tarife per autorizim karburanti + lende djegese | 7,000 | 6,239 | 10,000 | 10,200 | 10,404 | 10,612 |
| 11 | Tarife per vertetime | 1,426 | 1,456 | 2,130 | 2,173 | 2,216 | 2,260 |
| 12 | Tarife zgjatje orari | 1,825 | 2,019 | 3,700 | 3,774 | 3,849 | 3,926 |
| 13 | Tarife karrotrec | 33 | 27 | 300 | 306 | 312 | 318 |
| 14 | Tarife leje perdorimi per objekte biznesi | 1,015 | 2,156 | 1,500 | 1,530 | 1,561 | 1,592 |
| 15 | Tarife leje perdorimi per objekte banimi | 554 | 737 | 2,000 | 2,040 | 2,081 | 2,122 |
| 16 | Tarife certifikim relievi | 1,027 | 840 | 2,300 | 2,346 | 2,393 | 2,441 |
| 17 | Tarife deklarim paraprak | 785 | 1,183 | 800 | 816 | 832 | 849 |
| 18 | Tarife trajtim fasade te ndertesave | 1,150 | 1,291 | 3,000 | 3,060 | 3,121 | 3,184 |
| 19 | Tarife aplikim leje zhvillimi | 340 | 75 | 500 | 510 | 520 | 531 |
| 20 | Tarife hartim PDV per siperfaqen e prones | 4,081 | 1,734 | 2,000 | 2,040 | 2,081 | 2,122 |
| 21 | Tarife shqyrtim dok.leje ndertimi | 1,181 | 1,969 | 2,900 | 2,958 | 3,017 | 3,078 |
| 22 | Tarife kantier ndertimi brenda prones | 4,085 | 6,295 | 7,000 | 7,140 | 7,283 | 7,428 |
| 23 | Tarife depozitim I mbetjeve te ngurta | 14,807 | 17,954 | 15,000 | 15,300 | 15,606 | 15,918 |
| 24 | Tarife dokumenta nga arkiva | 29 | 44 | 100 | 102 | 104 | 106 |
| 25 | Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te bardha | 2,197 | 2,197 | 2,200 | 2,244 | 2,289 | 2,335 |
| 26 | Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te zeza | 283 | 283 | 300 | 306 | 312 | 318 |
| 27 | Tarife sherbimi per rrjetin kabllor | 3,455 | 3,300 | 6,000 | 6,120 | 6,242 | 6,367 |
| 28 | Tarife uji i pijshem | 9 | 1 | 20 | 20 | 21 | 21 |
| 29 | Tarife ndotje mjedisi | 25,372 | 28,510 | 42,000 | 42,840 | 43,697 | 44,571 |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura te tjera (jo tatimore)** | **33,850** | **20,104** | **161,968** | **119,298** | **121,676** | **124,099** |
| 1 | Qera objekti | 646 | 456 | 450 | 450 | 450 | 450 |
| 2 | Qera trualli | | 0 | 4,208 | 4,292 | 4,378 | 4,466 |
| 3 | Qera toke bujqesore | 514 | 215 | 310 | 316 | 323 | 329 |
| 4 | Gjoba ndertimi | 2,200 | 200 | 50,000 | 51,000 | 52,020 | 53,060 |
| 5 | Gjoba biznesi | 10,821 | 11,598 | 12,000 | 12,240 | 12,485 | 12,734 |
| 6 | Gjoba Policia Bashkiake | 845 | 3,077 | 5,000 | 5,100 | 5,202 | 5,306 |
| 7 | Te ardhura nga legalizimet | 4,362 | 1,575 | 45,000 | 45,900 | 46,818 | 47,754 |
| 8 | Te ardhura nga shitja e aksioneve (FK) | 14,127 | | 45,000 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | Sekuestrime dhe zhdemtime | 335 | | | | | |
| 10 | Kontribut subjekte private ne fondin publik te banesave sociale | | 2,983 | | | | |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura nga institucionet vartese** | **55,820** | **55,053** | **80,653** | **81,924** | **83,413** | **84,931** |
| 1 | Kopeshte (QEA) | 17,764 | 18,717 | 35,622 | 36,334 | 37,061 | 37,802 |
| 2 | Çerdhe (QEA) | 7,195 | 7,138 | 14,714 | 15,008 | 15,308 | 15,615 |
| 3 | Qera objekti (QEA) | 8,189 | 8,252 | 8,201 | 8,201 | 8,365 | 8,532 |
| 4 | Klubi Shumesporte | 1,262 | 1,482 | 1,346 | 1,346 | 1,373 | 1,400 |
| 5 | Teatri 'Skampa" | 990 | 1,425 | 1,100 | 1,122 | 1,144 | 1,167 |
| 6 | Trashegimia Kulturore dhe Turizmi | 276 | 437 | 70 | 71 | 73 | 74 |
| 7 | Sherbimet Publike | 11,640 | 10,120 | 12,100 | 12,342 | 12,589 | 12,841 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Menaxhimi Banesave Sociale | 8,504 | 7,482 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura nga funksionet specifike** | **39,229** | **27,842** | **75,015** | **76,515** | **78,046** | **79,607** |
| 1 | Tarifa sherbimi te MZSH | 1,173 | 1,460 | 2,200 | 2,244 | 2,289 | 2,335 |
| 2 | Tarifa te sherbimit pyjor | 30,191 | 18,445 | 65,565 | 66,876 | 68,214 | 69,578 |
| 3 | Tarifa nga ujitja dhe kullimi | 7,865 | 7,937 | 7,250 | 7,395 | 7,543 | 7,694 |
| | | | | | | | |
| | **Totali I :** | **1,136,136** | **1,063,432** | **1,792,182** | **1,781,774** | **1,817,255** | **1,853,438** |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura nga huaja** | **0** | | **83,778** | **0** | **0** | **0** |
| | **Transferta e pakushtezuar** | **1,116,323** | **1,147,754** | **1,239,785** | **1,296,667** | **1,359,029** | **1,421,780** |
| | **Transferta specifike** | **567,577** | **668,618** | **762,129** | **777,372** | **792,919** | **800,848** |
| | **Te ardhura te trasheguara** | **381,513** | **419,189** | **135,226** | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | **Totali II** | **3,201,549** | **3,298,993** | **4,013,100** | **3,855,813** | **3,969,203** | **4,076,066** |
| | | | | | | | |
| | **Te ardhura jasht limitit** | **53,875** | **27,665** | **29,200** | **29,784** | **30,380** | **30,987** |
| 1 | Takse pulle (agjent tatimor) | 146 | 141 | 200 | 204 | 208 | 212 |
| 2 | Sponsorizim | 29,625 | 3,060 | 4,000 | 4,080 | 4,162 | 4,245 |
| 3 | Transferta K.Qarkut | 24,104 | 24,464 | 25,000 | 25,500 | 26,010 | 26,530 |
| | | | | | | | |
| | **Gjithsej te ardhura :** | **3,255,424** | **3,326,658** | **4,042,300** | **3,885,597** | **3,999,583** | **4,107,053** |
| | | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

1505/2.
8.04.2026.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 400/1 Prot

Elbasan, më 07.4.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.41, datë 27.03.2026 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2027-2029", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 401
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 1571/1 Prot.**

**Datë 30 .03. 2026**

# VENDIM

**NR. 42 , DATË 27 . 03 . 2026**

**MBI**

## "TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029"

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë 27 . 03. 2026, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, "Mbi tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029", mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029",

**VENDOSI :**

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2027-2029, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETAR**
**Elsid Zyma**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

| | |
|---|---|
| Dr.Buxhet Fin.: | A.Merkja |
| D.P.Sh.M: | S. Mehmeti |
| D.P.K.S.A.R.S: | D.Rroseni |
| D.P.M.C.M.B.P: | Sh. Çullhaj |
| Dr.Juridike: | A.Hoxha |
| Zv/kryetar : | A. Shehu |
| Zv/kryetar : | A. Sula |
| Zv/kryetar : | K. Krasnika |

hkia Elbasan
grami Buxhetor Afatmesem 2027-2029

anet pergatitore te shpenzimeve per vitet 2027-2029

ne 000/leke

| Emertimi programit | Programi | Viti 2027 | | | | Viti 2028 | | | | Viti 2029 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shpenzime personeli | Shpenzime te tjera korente | Shpenzim e Kapitale | Totali buxhetit | Shpenzime personeli | Shpenzime te tjera korente | Shpenzime Kapitale | Totali buxhetit | Shpenzime personeli | Shpenzime te tjera korente | Shpenzim e Kapitale | Totali buxhetit |
| Menaxhimi dhe sherbimet mbeshtetese | AA109 | 461,158 | 136,286 | 19,000 | 616,444 | 461,158 | 136,277 | 20,900 | 618,335 | 472,687 | 136,277 | 21,187 | 630,151 |
| | | | | 0 | 0 | | | | | | | | |
| Rendi dhe siguria publike | AB109 | 111,842 | 107,286 | 44,319 | 263,447 | 111,842 | 110,397 | 48,751 | 270,990 | 114,638 | 113,378 | 51,676 | 279,692 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Çeshtjet ekonomike dhe bujqesia | AC109 | 186,256 | 87,050 | 308,946 | 582,252 | 186,256 | 87,050 | 350,513 | 623,819 | 190,912 | 87,050 | 371,544 | 649,506 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Mbrojtja e mjedisit | AD109 | 33,435 | 301,449 | 61,509 | 396,393 | 33,435 | 306,338 | 87,660 | 427,433 | 34,271 | 307,357 | 92,920 | 434,548 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Zhvillimi urban dhe sherbimet publike | AE109 | 171,688 | 262,711 | 43,554 | 477,953 | 171,688 | 262,711 | 47,909 | 482,308 | 175,980 | 262,711 | 50,784 | 489,475 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Argetimi, kultura dhe sportet | AF109 | 105,831 | 125,544 | 36,580 | 267,955 | 105,831 | 125,544 | 40,238 | 271,613 | 108,477 | 125,544 | 42,652 | 276,673 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Arsimi | AG109 | 605,606 | 129,322 | 163,374 | 898,302 | 605,606 | 129,322 | 179,712 | 914,640 | 620,746 | 129,322 | 190,495 | 940,563 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| Mbrojtja sociale | AH109 | 199,553 | 77,361 | 75,937 | 352,851 | 199,553 | 77,361 | 83,531 | 360,445 | 204,542 | 77,361 | 88,542 | 370,445 |
| | | | | | 0 | | | | | | | | |
| F.Rezerve & Kontigjenca | AI109 | 0 | 30,000 | | 30,000 | 0 | 30,000 | 0 | 30,000 | 0 | 36,000 | 0 | 36,000 |
| | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithsej : | | 1,875,369 | 1,257,009 | 753,219 | 3,885,597 | 1,875,369 | 1,265,000 | 859,214 | 3,999,583 | 1,922,253 | 1,275,000 | 909,800 | 4,107,053 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

1571/2
8.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

**Nr. 401/1 Prot** **Elbasan, më 7.4.2026**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.42, datë 27.03.2026 "Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 402
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

**Nr.** 1540 **Prot** **Datë** 30.03 **.2026**

**VENDIM**

**Nr.** 43 **Datë** 27.03 **.2026**

**"Për një shtesë në pikën 9 të lidhjes nr. 1 të VKB nr. 155 datë 24.12.2025"**

Këshilli Bashkiak , në mbledhjen e tij të datës 27 / 03 /2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore për një shtesë në pikën nr. 9 të lidhjes nr. 1 të VKB nr. 155 datë 24.12.2025

**VENDOSI :**

1.Të miratojë në lidhjen nr.1 të nivelit të pageve për funksionarët, nëpunësit civilë dhe punonjësit e Bashkisë Elbasan në pikën 9 të VKB nr. 155 datë 24.12.2025 do të shtohet pozicioni i punës Koordinator i Emigracionit në Bashkinë Elbasan, me klasë II-2,si dhe me pagë për pozicion 100,000 lekë .

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore,si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

| | |
|---|---|
| Konceptoi: | SpecialistDABNJ M.Biba |
| Pranoi: | Drejtor DABNJ L.Dervishi |
| | Drejtor DBF A.Merkja |
| | Drejtori J.IA.Hoxha |
| Miratoi: | Drejtori i Përgjithshëm S.Mehmeti |
| Konfirmoi: | Zv.Kryetar K.Krasnika |

**Sekretari i Këshillit Bashkiak** **Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**ELSID ZYMA** **LUTFI LALA**

15~~40~~12
01.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 402/1 Prot.

Elbasan më 1.4.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.43 datë 27.03.2026 "Për një shtesë në pikën 9 të lidhjes nr.1 të VKB nr.155 datë 24.12.2025" konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 403
Dt. 30.3.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. 1530/1 Prot. Elbasan më, 30.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 44 Datë 27.03.2026**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapi banues në fshatin Murras të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028 si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Mehmet Sadik Vrapi,** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në **1,440,466** (një milion e katërqind e dyzet mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. **1,562,268 [1] x 50% = 781,134+ 659,332 [2] = 1,440,466 lekë.**
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, i miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elsid Zyma**

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi**: | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| | Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| **Konfirmoi:** | Zv/Kryetari | A.Sula |

1520/2
16.04.2026

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
## SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

**Nr.** 403/1 **Prot.** **Elbasan, më** 10.4**.2026**

**Lënda**: Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa:Lagjja " Br.17 Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 44 datë 27.03.2026 me Lëndë: "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Mehmet Sadik Vrapi, banues në fshatin Murras të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e bashkisë Elbasan, ( në vlerën 1.440.466 lekë), konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 404
Dt. 30.3.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. 1518/1 Prot. Elbasan më, 30.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 45 Datë 27.03.2026**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë) banues në fshatin Vidhas të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028". si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Dalip Jonuz Verçani (i ndjerë),** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në vlerën totale prej **749,577** (shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. **390,179 [1] x 50% = 195,090 +54,487 [2] + 500,000[3] =749,577 lekë.**

3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak ";

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi
[3] Masa e ndihmës financiare për personik që ka ndërruar jetë nga zjarri i rënë

VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028".

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** | **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** |
| **Elsid Zyma** | **Lutfi Lala** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

| | |
|---|---|
| Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| Dr. Juridike | A. Hoxha |

| | | |
|---|---|---|
| **Konfirmoi:** | Zv/Kryetari | A.Sula |

15/8/2
16.04.2026.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE**

**Nr.** 404/1 **Prot.** **Elbasan, më** 12.4 **.2026**

**Lënda:** Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa:Lagjja " Br.17 Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 45 datë 27.03.2026 me Lëndë: "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Dalip Jonuz Verçani, banues në fshatin Vidhas të Njësisë Administrative Papër dhe dhënien e kompensimit nga ana e bashkisë Elbasan, ( në vlerën 749,577 lekë), konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 405
Dt. 30.3.202

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. 1513/1 Prot. Elbasan më, 30.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 46 Datë 27.03.2026**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Xhimi Hajredin Skënderi banues në lagjen "Aqif Pasha", nr. 4 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e vlerës financiare të kompensimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Xhimi Hajredin Skënderi** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është **1,097,005** (një milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesë ) lekë.

   Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. **1,080,464 [1] x 50% = 540,232+ 556,773 [2] = 1,097,005 lekë.**

2. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028".

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** | **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** |
| **Elsid Zyma** | **Lutfi Lala** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| | Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| **Konfirmoi:** | Zv/Kryetari | A.Sula |

1519/2.
16.04.2026

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
## SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

**Nr.** 405/1 **Prot.** **Elbasan, më** 10.4**.2026**

**Lënda:** Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa:Lagjja " Br.17 Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 46 datë 27.03.2026 me Lëndë: "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Xhimi Hajredin Skënderi, banues në lagjen "Aqif Pasha", nr.4 dhe dhënien e kompensimit nga ana e bashkisë Elbasan, ( në vlerën 1,097,005 lekë), konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lagjia:Brig. "17.Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa" E-mail : prefekti.elbasan@mb.gov.al Tel: 054 25 21 38, Fax: 054 25 24 46

Nr. 406
Dt. 30.3.2026

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
## BASHKIA ELBASAN
## KËSHILLI BASHKIAK

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. 1523/1 Prot. Elbasan më, 30.03.2026

## VENDIM

**Nr. 47 Datë 27.03.2026**

**"Për miratimin e përdorimit të një pjesë të fondit të Emergjencave Civile dhe kalimin e tij Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 7 të tij; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Buxhet Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

## KËSHILLI BASHKIAK

## VENDOSI

1. Kalimin e fondit prej **453,260** (katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë nga buxheti i Emergjencave Civile në buxhetin e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale.
2. Miratimin e përdorimit të këtij fondi për kryerjen e punimeve për shkatërrimin e masivit shkëmbor në fshatin Shëmhill, Njësia Administrative Bradashesh.
3. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028".

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale.
Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

| SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK | KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK |
|---|---|
| **Elsid Zyma** | **Lutfi Lala** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | Specialist | I. Hoxholli |
| **Pranoi:** | Drejtori MC | N. Sinani |
| **Miratoi:** | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |
| | Dr. Buxhet Financë | A. Merkja |
| | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| **Konfirmoi:** | Zv/Kryetari | K. Krasnika |

1529/2.
16.04.2026.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE**

**Nr.** 406/1 **Prot.** **Elbasan, më** 10.4**.2026**

**Lënda**: Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa:Lagjja " Br.17 Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 47 datë 27.03.2026 "Për miratimin e përdorimit të një pjesë të Fondit të Emergjencave Civile dhe kalimin e tij Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lagjia:Brig. "17.Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa" E-mail : *prefekti.elbasan@mb.gov.al* Tel: 054 25 21 38, Fax: 054 25 24 46

407
30.03.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

**Nr.1593/Prot** **Datë30.03.2026**

**VENDIM**
**Nr. 48 Datë27.03.2026**

**"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, neni 54, ", të **ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe** Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,"
Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr.____datë:_________

**VENDOSI :**

4. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:.

| Nr | **Targa e mjetit** | **Tipi I mjetit** | **Norma e konsumit** | **Karburanti** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AB716YD | Kamion me kazan vetëshkarkues VOLVO FL | 25 Litra/100 km | GazoiL D1 |
| 2 | AB488YN | Kamion IVECO 180E për largimin e mbetjeve | 5 Litra/orë pune | GazoiL D1 |

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha
Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli
Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

**Sekretari i Këshillit Bashkiak** **Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**ELSID ZYMA** **LUTFI LALA**

1593/2.
09.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 407/1 Prot.

Elbasan më 3.04.2026

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.48, datë 27.03.2026, "Për një shtesë në VKB nr.16,datë 29.01.2025 'Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorike në administrim të ASHPR' " konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

BASHKIA ELBASAN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN**

Nr. 1594/1 prot                                                                 Datë 30.03.2026

**Vendim**

Nr 49, datë 27.03.2026

**Raport mbi Veprimtarinë e Këshillit Bashkiak për Vitin 2025 dhe Transparencën në Proçesin e Vendimarrjes dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak.**

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektar parimet e demokracisë vendore, Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me efektivitet dhe efiçencë burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore, duke punuar bazuar në parimet e interesit publik, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

**Pjesëmarja këshilltareve në aktivitete:**

a) Mbledhje plenare
b) Mbledhje në komisione
c) Konsultime
d) Trajnime
e) Aktivitete të tjera
f) Vendimarrja e Këshillit

Këshilli i Bashkisë Elbasan, gjatë vitit 2025 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i përkasin shërbimit ndaj qytetareve, zhvillimit të qytetit, mbeshtetjes dhe promovimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë (bujqësisë, industrisë, shërbimeve, tregtisë, turizmit, etj) me ndihmë ekonomike dhe vendimet me karakter ekonomik që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e buxhetit për vitin 2026, projektet e propozuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet; dhe
2. Ka marre vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetem nga fondi i kushtëzuar, por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan si më poshtë:

| Nr. | Muaji | Ndihme ekonomike per familje nga te ardhurat e Bashkise | Ndihme ekonomike per familje nga Fondi i kushtezuar 6 % |
|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 1 | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Shkurt | 1 | 1 |
| 3 | Mars | 1 | 1 |
| 4 | Prill | 1 | 1 |
| 5 | Maj | 1 | 1 |
| 6 | Qershor | 1 | 1 |
| 7 | Korrik | 1 | 1 |
| 8 | Gusht | 1 | 1 |
| 9 | Shtator | 1 | 1 |
| 10 | Tetor | 1 | 1 |
| 11 | Nentor | 1 | 1 |
| 12 | Dhjetor | 1 | 1 |

**Të tjera vendime të miratuara:**

- Dhënie me qera të tokave bujqësore, lista e sipërfaqeve kullosore dimerore dhe verore, me qellim miremenaxhimin e tyre dhe perdorimin e ketyre tokave ne dobi te fermereve dhe zhvillimit te bujqesise;
- Shtesa dhe ndryshime te buxhetit per vitin 2025 me qellim rritjen e efikasitetit te burimeve financiare dhe perdorimin e tyre ne sherbim te komunitetit, zhvillimit urban dhe rural, thithjes se investimeve dhe mbeshtetjes se ekzekutivit ne projektet e fituara nga qeveria qendrore, me fonde te Bashkimit Europian (BE), dhe donatore te trere te huaj;
- Buxhetin e vitit 2026 dhe projekt-buxhetin afatmesem te Bashkise Elbasan per vitet 2025-2027;
- Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne bashkine Elbasan per vitin 2026;
- Dhenie te titujve "Qytetar Nderi bazuar ne kerkesat dhe trajtimin e dy komisioneve;
- Bursat per nxenesit e arsimit para-universitar dhe konviktet e shkollave te mesme profesionale, per vitin shkollor 2025-2026, si dhe mbeshtetjen e nxenesve ekselente.

**Struktura e vendime të miratuara nga Këshilli viti 2025**

- Nga totali 161 vendime te marra 154 vendime kane kerkuar konfirmimin e Prefektit te Qarkut nga te cilet 154 vendime jane konfirmuar dhe 0 jane kthyer, te cilet pas plotesimeve te kerkuara nga instucioni i Prefektit te Qarkut jane kaluar ne mbledhjet e radhes;
- Vendimet me karakter normativ kane pasur te bejne me buxhetin dhe zbatimin e tij, permiresimin e sherbimeve, detajimin e shpemdarjes se buxhetit etj;
- Dhenie t e tokave me qera, mbeshtetjen e projekteve te fituara nga ekzekutivi, planet vendore per pastrimin, mbrojtjen nga zjarri, planet sociale te bashkise si dhe vendimet per mbeshtetjen e familjeve qe kane patur demtime te banesave te tyre nga zjarri;
- Vendimet te cilat jane me karakter personal, 24 prej tyre kane te bejne me dhenien e ndihmes ekonomike sipas muajve, vendime per procesin e privatizimit te banesave per lidhjen e kontratave para noterit, per banesat e para viteve 90, vendime per miratimin e listes se perfituesve te subvencionit te qirase dhe subvencionit te kredise, vendime per

shtyrjen e afatit te kredise si dhe per vendosjen ne Shtepine e te Moshuarve si dhe titujt e nderit;

- 2 vendime me karakter jo normativ jane vendime qe kane te bejne me procedurat e zhvilluara mbi vendosjen në insitucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.
- Dhene 5 tituj "Qytetar Nderi".

Keto vendime te Keshillit, tregojne bashkepunimin e Keshillit me administraten e Bashkise per t'ju pergjigjur ne kohe dhe sipas legjislacionit ne fuqi gjithe shqetesimeve dhe problematikave te komunitetit te qytetit te Elbasanit dhe njesive administrative.
Keshilli gjate kesaj periudhe ka qene aktiv, duke mbajtur mbledhje te radhes, mbledhje jashte radhe, sipas tabeles se meposhteme:

| Muaji | Nr total i Mbledhjeve | Mbledhje te radhes | Mbledhje jashte radhe |
|---|---|---|---|
| Janar | 1 | 1 | - |
| Shkurt | 2 | 1 | 1 |
| Mars | 1 | 1 | - |
| Prill | 1 | 1 | - |
| Maj | 1 | 1 | - |
| Qershor | 1 | 1 | - |
| Korrik | 2 | 1 | 1 |
| Gusht | 1 | 1 | - |
| Shtator | 1 | 1 | - |
| Tetor | 1 | 1 | - |
| Nentor | 1 | 1 | - |
| Dhjetor | 1 | 1 | - |

Gjate vitit 2025 nuk është zhvilluar asnjë mbledhje online.
Pjesemanja e keshilltareve ka qene aktive si ne mbledhjet e komisioneve ashtu dhe ne proçesin e vendimmanjes ne mbledhjet plenare online apo ato fizike. Komisionet e perhershme te Keshillit jane mbledhur per te diskutuar dhe miratuar projekt vendime te sjella nga administrata e Bashkise Elbasan qe kane te bejne sidomos me vendimet me karakter ekonomik dhe ne dhenien e pronave me qera, titujt e nderit, çeshtje juridike etj.

Ne vitin 2025 jane zhvilluar 12 mbledhje te Komisioneve.

| Nr | Muaji | Mbledhje të Komisione të Përhershme |
|---|---|---|
| 1 | Janar | 1 |
| 2 | Shkurt | 2 |
| 3 | Mars | 1 |
| 4 | Prill | 1 |
| 5 | Maj | 1 |
| 6 | Qershor | 1 |
| 7 | Korrik | 2 |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Gusht | 1 |
| 9 | Shtator | 1 |
| 10 | Tetor | 1 |
| 11 | Nentor | 1 |
| 12 | Dhjetor | 1 |
| | Total | 14 |

Duke u nisur nga karakteri i vendimeve, ato ndahen në vendime për çështje:

1. Financiare;
2. Sociale
3. Infrastrukturen dhe strehimin
4. Problemet urbane dhe asetet
5. Emergjencat civile;
6. Çeshtje te arsimit kultures;
7. Tajtimi i mbetjeve;
8. Planet lokale

**Tranaparenca e Këshillit.**

Ne zbatim te rregulloreve te miratuara eshte vene ne funksionim regjistri elektronik i ankesave/kerkesave dhe regjistri elektronik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen te gjitha ankesat/kerkesat e mberritura ne drejtim te Keshillit te Bashksie, regjistri elektronik i mbledhjeve te Keshillit me te gjitha kolonat qe sigurojne informacion te plote per zhvillimin e mbledhjeve, dhe regjistri elektronik i projektakteve (ne faqen e internetit te bashkise, rubrika Keshilli).

Gjate vitit 2025 u depozituan ne total 15 këkesa drejtuar Keshillit Bashkiak. Kerkesat jane trajtuar dhe jane koordinuar me ekzekutivin e bashkise dhe ne te gjitha rastet jane informuar qytetaret.

Eshte pasuruar faqja e internetit te Bashkise, Rubrika e Keshillit Bashkiak me informacione per publikun nepermjet kategorive te meposhtme:

- Anetaret e Keshillit Bashkiak;
- Struktura/Komisionet;
- Rregulloret e Keshillit;
- Vendime te Keshillit Bashkiak;
- Vendimet e Kryesise;
- Njoftimet e Mbledhjeve;
- Projektvendimet;
- Procesverbalet;
- Regjistri elektronik i kerkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare;
- Regjistri elektronik i mbledhjeve;
- Regjistri elektronik i projektakteve;
- Konsultimet publike;
- Aktivitete te Keshillit, etj

Gjithçka me lart behet transparente, dhe qytetaret mund t'i gjejne ne faqen e internetit te Bashkise, rubrkika Keshilli te gjitha informacionet dhe dokumentat perkatese.
Per te thelluar me shume transparencen, Keshilli i paisur dhe mbeshtetur nga Projekti Bashki te Forta me paisje IT te plota (donacion-Ekran, Kamera, Miktofona, Laptop, dhe kabllo), ka regjistruar dhe transmetuar direkt (live) ne facebook te Keshillit gjashte nga dymbedhjete mbledhje te Keshillit gjate vitit 2025.

**Roli perfaqesues i Keshillit**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 **"Per Veteqeverisjen Vendore"**, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014, **"Per konsultimin Publik"**, ne zbatim te planit te aktiviteteve/punes dhe pergatitjes se Tavaneve Buxhetore te Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2026-2028, paketes Fiskale 2026, dokumentin final te PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026, Keshilli ne bashkepunim me ekzekutivin kane marre pjese ne 37 degjesa publike ne te gjitha njesite administrative te bashkise me grupe te ndryshme interesi, perfshire **"keshillin rinor"**, grate grupet vulnerable, etj, qe kane te bejne me hartimin e Paketes Fiskale per vitin 2026, me zbatimin e buxhetit per vitin 2025 dhe kerkesat buxhetore per vitin 2026, persa i perket miratimit te sistemit te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2026, te buxhetit te Bashkise Elbasan per vitin 2026 si dhe projekt-buxhetit afatmesem te Bashkise Elbasan per vitet 2026-2028.
Aktivitetet e mesipere u publikuan ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Duke konsideruar rendesine e pjesemarrjes se grupeve vulnerable ne procesin e vendimmarrjes, Keshilli ne zbatim te planit te aktiviteteve/punes se tij, me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, zhvilloi ne 26 Maj 2025 nje konsultim/degjese te veçante me komunitetin Egjiptian dhe Rom per marrjen e nevojave dhe prioriteteve te ketyre komuniteteve dhe kosiderimin e prioriteteve te tyre ne buxhetin e vitit 2026 dhe ne PBA 2026-2028. Aktiviteti u publikua ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, regjistrin elektronik te projektakteve per konsultim publik, dhe ne facebook te Keshillit.

Keshilli ka marre pjese ne seanca degjimore se bashku me administraten e Bashkise ku jane mbajtur shenim kerkesat, sugjerimet dhe opinionet e pjesemarresve, i jane percjelle Komisionit te Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, dhe jane reflektuar/konsideruar ne dokumentat perkatese.

Te gjitha degjesat/konsultimet publike te siperpermendura jane publikuar ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, regjistrin elektronik te projektakteve per konsultim publik, dhe ne facebook te Keshillit.
Gjate mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, keshtillaret kane shprehur kerkesa dhe ankesa te qytetareve te zonave qe perfaqesojne te cilat i jane parashtruar ekzekutivit dhe jane diskutuar me tej per te marre zgjidhje rast pas rasti.

Per vitin 2025 buxheti i Keshillit Bashkiak eshte realizuar pothuajse i plote.

**Barazia gjinore dhe Aleanca e Grave Këshilltare**

Komisioni i Sherbimeve, Strehimit Social, Shendetsise dhe Barazise Gjinore ne bashkepunimme

BASHKIA ELBASAN

Aleancen e Grave Keshilltare (AGKB) te Bashkise Elbasan, adresuan çeshtje te te ndryshme qe sigurojne barazine gjinore ne veprimtarine Bashkise Elbasan dhe se bashku zbatuan aktivitete te nismes - reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

**Mbajtja e dokumentacionit**

Me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, sekretariati i Keshillit eshte paisur me dosje dhe mbajtja e dokumentacionit eshte si me poshte:

- Dosja e Protokollit te Brendshem (Nderveprimi me Administraten)
- Dosja e korespondences me Prefektin.
- Dosja per Prjekt-Vendimet
- Dosja per Vendimet e Keshillit
- Dosja e Vendimeve dhe Proces Verbalet e mbledhjeve te Kryesise
- Dosjet e Proces Verbaleve te Mbledhjeve te Keshillit (Minutes)
- Dosjet e Proces Verbaleve te Votimit.
- Dosjet e Komisioneve
- Dosjet per Proceset e konsultimeve + Regjistri i Konsultimeve
- Dosjet e Grupeve Politike (nderveprimit te Keshillit me to)
- Dosjet me kerkesat e Keshilltareve per Informim me dok zyrtar
- Dosje per ankesat kerkesat + Regjistri Perkates
- Dosje per Nismat + Regjistri
- Dosje per Planet e punes se keshillit si dhe Buxhetin perkates (nderveprimi me administraten per shoenzimet)
- Dosjet per titujt e nderit dhe komisione te ndryshme qytetare

**Vazhdimesia dhe e Ardhmja**

Mbetet si detyre mjaft e rendesishme per te ardhmen gjetja e menyrave dhe formave te tjera per te komunikuar me publikun per çeshtje si: diskutimi per buxhetin e bashkise, paketes fiskale, tjetersimit dhe dhenies me qera te pronave, zbatimi i standardeve e rregulloreve etj. me qellim pjesemarrjen aktive ne vendimmanje te komunitetit, ku çdo keshilltar per aktet normative, te cilat do te diskutohet dhe vendoset ne Keshill, te marre opinionet dhe verejtjet publike ne lagjen ose fshatin qe ata perfaqesojne me qellim qe vendim-marrja te jete ne sherbim te komunitetit.

Gjithashtu, mbledhjet e komisioneve duhet te zhvillohen rregullisht, te mbahen procesverbalet dhe pergatiten raportet e vendimarrjes per cdo projekt akt te shqyrtuar dhe prezantuar ne mbledhjet plenare te Keshillit.
Per sa me siper ju falenderojme secilin per kontributin e dhene dhe ju ftojme te jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja per permiresimin e punes se Keshillit.

Konc. L. Guri

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi LALA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

Nr. 431
Dt. 02.04.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr 1536/1 prot                                                  Elbasan, më 01.04.2026

**VENDIM**

**Nr.50, datë 27/03/2026**

**PËR**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK – KONTRATA E QYTETIT PËR KLIMËN"**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 27/03/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

**VENDOSI**

1. Të miratojë: Planin Strategjik – Kontrata e Qytetit për Klimën.
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan si: Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Kulturës dhe Turizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës, Arsimit, Rinisë e Sporteve, Drejtoria e Projektimit Urban, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Koordinatorin për Informim dhe Konsultim Publik, Drejtoria e Integrimit Europian, Projekteve dhe Donatorëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi:
P.Sek 100. Q.: A.Hodaj
D.D.I.E.P.I E.Çuni
Dr.Përgj. Zh.Ek.K.T.: A. Canaj
Dr. Përgj.M.M.B.P.K: Sh. Çullhaj
Dr. Përgj. K.S.A.R.S: D. Rroseni
D.D.P.U: M. Avllazagai
D.B.F: A. Merkja
D.D.J: A. Hoxha
Miratoi: Zv/ Kryetare: K. Krasnika

Sekretari i Keshillit Bashkiak
Elsid ZYMA

Kryetar i Keshillit Bashkiak
Lutfi LALA

1536/2
09.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 431/1 prot. Elbasan, më 9.4.2026

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.50 datë 27.03.2026 "Për miratimin e planit strategjik – kontrata e qytetit për klimën" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.1816 prot | Datë 02.04.2026

**Vendim**

Nr 51, datë 27.03.2026

**"Kalendari i Konsultimeve Publike për Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029"**

Bashkia Elbasan do të informojë komunitetin mbi të dhënat për zbatimit e buxhetit të bashkisë për gjashtë-mujorin e parë të vitit

2025 dhe në vazhdim, projektet për secilin program buxhetor te PBA 2027-2029, draft Buxhetin per vitin 2025, shërbimet e ofruara nga Bashkia dhe draft Paketen Fiskale per vitin 2025

**Qellimi**

Kërkohet opinioni i qytetarëve dhe grupeve të interesit, perfshire grupet vulnerabel, për projektet e PBA 2027-2029, per draft Buxhetin per vitin 2027, shërbimet prioritare të komunitetit.

**Grupet që do të konsultohen:**

Banorët e qytetit te Elbasanit dhe te gjitha Njesite Administrative të Bashkisë Elbasan, përfaqësues të biznesit, banoret e bashkise perfshire grupet vulnerabel (Roma, Egjiptian) kryetarët e fshatrave, mësues, përfaqësues te organizatave jo-fitimprurese te grave, rinise, grupeve me aftesi te kufizuara) etj.

**Kalendari**

| Nr | Aktiviteti | Data | Vendi | Ora | Mënyra | Forma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Konsultim publik me banorë, biznese, OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, ne qytetin **Elbasan** | 20.04.2026 | | 09:00 | Takim publik | Bisedë |
| 2 | Konsultim publik me banorët, Kryetare Fshatrash te Njësisë Administrative **Bradashesh** etj. | 20.04.2026 | NjësAdm Bradashesh | 12:00 | Takim publik | Bisedë |
| 3 | Konsultim publik me banorë, Kryetare Fshatrash, mësues, etj te Njësisë Administrative **Funar** | 21.04.2026 | NjësiaAdm Funar | 09:00 | Takim publik | Bisedë |
| 4 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Gjergjan**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 21.04.2026 | Njësia Adm Gjergjan | 11:00 | Takim publik | Bisedë |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Gracen**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 23.04.2026 | Njësia Adm Gracen | 11:00 | Takim publik | Bisedë |
| 7 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Labinot Mal**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 24.04.2026 | Njësia Adm Labinot Mal | 09:00 | Takim publik | Bisedë |
| 8 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Labinot Fushe**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 24.04.2026 | Njësia Adm Labinot Fushe | 10:00 | Takim publik | Bisedë |
| 9 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Paper**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 24.04.2026 | Njësia Adm Paper | 12:00 | Takim publik | Bisedë |
| 10 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Shirgjan**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 27.04.2026 | Njësia Adm Shirgjan | 09:00 | Takim publik | Bisedë |
| 11 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Shushice**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 28.04.2026 | Njësia Adm Shushice | 10:00 | Takim publik | Bisedë |
| 12 | Konsultim me banorët e Njesise Administrative **Zavaline**, Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj. | 28.04.2026 | Njësia Adm Zavaline | 12:00 | Takim publik | Bisedë |
| 13 | Degjese publike me organizatat jo fitimprurese (OjF) lokale | 30.04.2026 | Elbasan | 09:00 | Takim publik | Bisede |

**Shënim:** Ky njoftim afishohet pranë zyrave të Njësisë Administrative, publikohet online në seksionin njoftime të faqes së internetit te Bashkisë, ne rubriken Keshilli Bashkiak dhe promovohet në rrjetet sociale, të paktën **10 ditë** parambajtjes së takimit të parë, dhe pas publikimit në faqen e internetit te Bshkise Elbasan të materialeve që do të konsultohen.

Të dhëna në lidhje me raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023, ne vazhdim viti 2024, së bashku me projektet e projekt buxhetit afatmesëm 2025 - 2027, Paketen Fiskale 2025 dhe opsionet që shtrohen para komunitetit si dhe në lidhje me procesin që do të ndiqet për trajtimin e rekomandimeve, jepen në Njoftimin për Konsultimin Publik të publikuar së bashku me këtë kalendar.

**SEKRETAR I KWSHILLIT BASHKIAK**
**ELSID ZYMA**

**KRYETAR I KWSHILLIT BASHKIAK**
**LUTFI LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN